



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 8681 | Prot.

Tiranë, më 15.10.2018

Lënda: Dërgim i raportit përfundimtar të auditimit

KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR
Rr. "Muhamet Gjollësia" Sheshi M.K.Ataturk

Tiranë

Nga data 20.08.2018 deri më 31.08.2018, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ka zhvilluar një mision auditimi, në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar me objekt "Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime në arritjen e objektivave", për periudhën 01.12.2016 deri më 31.08.2018.

Bashkëlidhur ju dërgojmë,

- Raportin Përfundimtar të auditimit.
- Formularin e plan-veprimit, për realizimin e rekomandimeve.
- Aneksin nr. 2, "Reagim nga subjekti i audituar"

Në zbatim të procedurave ligjore për auditimin e brendshëm, ju kujtojmë se:

- Brenda 30 ditëve, nga marrja e "Raportit Përfundimtar", drejtuesi i institucionit duhet të miratojë "Plan-Veprimin" për zbatimin e rekomandimeve, të sugjeruar nga audit, duke e dërguar atë të nënshkruar në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Në se institucioni i audituar, nuk përgjigjet me shkrim lidhur me pranimin e "Plan veprimit" dhe masat për zbatimin e rekomandimeve, drejtuesi i NjAB-së informon Ministrin që, drejtuesi dhe institucioni i audituar nuk kanë përmbushur përgjegjësitë e tyre ligjore.

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet tuaja për të na ndihmuar, të vlerësojmë performancën tonë personale dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë, duke plotësuar aneksin nr.2, bashkëlidhur.



MINISTËR

Lindita Nikolla

Raport - Përfundimtar Mbi

“Zbatimin e ligjshmërisë për përdorimin e fondeve si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime, në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar”.

Përmbledhje ekzekutive

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Ministri i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.8681/1 datë 17.08. 2018
Objekti: Mbi zbatimin e ligjshmërisë për përdorimin e fondeve si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

Subjekti i auditimit: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.

Periudha e audituar: 01.12.2016 deri më 31.08.2018

Auditimi ka filluar më: 20.08.2018

Auditimi ka përfunduar: 31.08.2018

Qëllimi: Të ndihmojë institucionin në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit dhe menaxhimit.

I Drejtimit kryesore të auditimit:

- Auditim, mbi zbatimin e kriterëve për përfitimin e fondeve buxhetore.
- Auditim i zërave të shpenzimeve që lejohen të përballohen nga fondi “grand/transferte korrente të brendshme” për KOKSH-in.
- Auditim i ligjshmërisë së dokumentacionit të paraqitur në MASR, nga përfituesit e fondeve “grand/transferte korrente të brendshme”.
- Auditimi i kontratave të punësimit për punonjësit që financohen me fondet e grand/transferte.
- Auditim i pasqyrave fanaciare të fondeve “grand/transferte korrente të brendshme”, të depozituara në MASR, brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave, referuar Ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Pasqyrat financiare duhet të jenë konform ligjit ku të përfshihen dhe të raportohen të gjitha të ardhurat nga burimet e ligjshme, si dhe të gjitha shpenzimet e kryera gjatë vitit ushtrimor.

II Metodologjia

- Testim hapa pas hapi, studim i dokumentacionit në KOKSH.

III Përbërja e grupit të auditimit

- Merita Tërshana Përgjegjëse grupi
- Vjollca Haxhiu Anëtare

Hyrje, mbi organizimin dhe funksionimin e KOKSH-it.

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar është organizuar dhe funksionon mbështetur në VKM nr.401, datë 22.08.1994 “Për një ndryshim në VKM nr.20, datë 24.01.1994 “Për ndarjen e KOKSH-i dhe krijimin e strukturës shtetërore të edukimit fizik dhe sporteve”. Sipas këtij vendimi KOKSH-i është një organizatë sportive pa qëllim fitimi, për 5 punonjës që financohet nga shteti, vetëm për pagat e punonjësve që merren me administrimin e institucionit.

Funksionimi mbështetet në Kartën Olimpikë dhe në statutin e tij.

Neni 11 i Ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin", i shfuqizuar, citon se, *KOSH është person juridik që themelohet dhe funksionon si shoqatë sportive.* Nga auditimi rezulton se KOSH nuk është regjistruar nga viti 2005 deri më 2018 në gjykatë duke mos zbatuar nenin 11 të ligjit të sipërcituar. Në zbatim të nenit 14 të ligjit nr.79/2017 "Për Sportin", me vendimin nr.5934, datë 22.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, KOKSH-i është regjistruar si person juridik.

KOKSH-i funksionon bazuar në statutin e hartuar më datë 12 dhjetor 2012 të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e 16-të si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të KOKSH-it të miratuar nga Komiteti Ekzekutiv. Nuk është hartuar statuti dhe rregullorja e re, në përputhje me Ligjin nr. 79/2017 "Për Sportin" dhe vendimin e gjykatës.

Organet e KOKSH-it janë:

- Asambleja e Përgjithshme, si organ vendimmarrës
- Komiteti Ekzekutiv, si organ ekzekutiv
- Presidenti dhe zv. Presidenti, i cili përfaqëson KOKSH-in në të gjitha aktivitetet e tij në përputhje me detyrat e caktuara në rregulloren e brendshme të KOKSH-it.
- Mbajtësi i thesarit
- Sekretar i Përgjithshëm, i cili drejton dhe organizon të gjithë veprimtarinë administrative të KOKSH-it.

Për përdorimin në mënyrë efektive të burimeve financiare dhe materiale është krijuar komisioni financë dhe marketim, i cili sipas rregullores së brendshme në neni 40 të saj, përcakton detyrat e këtij komisioni ndër të cilat janë

- hartimi i projekt buxhetit për vitin në vazhdim duke ja paraqitur Asamblesë së Përgjithshme për miratim
- shpërndarja e të ardhurave dhe kontrolli dhe përdorimi i tyre
- siguron inventarizimin vjetor të bazës materiale të KOKSH-it.

Bazuar në nenin 42 të rregullores së brendshme të KOKSH-it kontrolli financiar është i pavarur dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me një kontratë 4-vjecare. Audit i pavarur paraqet raportin vjetor të kontrollit të veprimtarisë financiare të KOKSH-it në Asamblenë e Përgjithshme. Nga ana e institucionit raporti vjetor i auditit nuk ju vu në dispozicion grupit të auditit.

Gjetje dhe konkluzione:

- Nuk është zbatuar pika 6, germa a,b,c dhe d. i Udhëzimit nr.4, datë 11.03.2014 "Për mënyrën e përdorimit të fondit Grand/Transfert korrente e brendëshme".
- Nuk janë raportuar të ardhurat përfituara nga burime të tjera të ligjshme, si dhe shpenzimet nuk janë raportuar në MASR, në kundërshtim me pikën 12, të udhëzimit nr 4, datë 11.03.2014.

Auditim, mbi zbatimin e kritereve për përfitimin e fondeve buxhetore.

Kriteri i vetëm për përfitimin e grand/transfertë korrente e brendshme për KOKSH-in është numri i punonjësve, pagat e përcaktuara me VKM dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore. Nga auditimi rezulton se kjo pikë është realizuar sipas pikave të Udhëzimit nr.4, datë 11.03.2014 "Për mënyrën e përdorimit të fondit Grand/Transfert korrente e brendëshme".

1. Auditimi i zërave të shpenzimeve që lejohen të përballohen nga fondi grand/transfer korrente të brendëshme” për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar si më poshtë:

a. Financimi i kontratave të punësimit.

-Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 23.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë , ligjit nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2016, nr. 17911/68, datë 10.01.2017 dhe nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018 nga ana e KOKSH-it është dërguar projekt buxheti në të cilën është paraqitur vetëm fondi pagave sipas strukturës së miratuar mbi bazën e të cilit për çdo vit është dërguar planifikimi i grandit si më poshtë:

-Buxheti në formë Grandi/transfertë korrente i detajuar gr. 11, titulli 08140, artikulli 604 detajohet nga Ministria për KOKSH, sipas kriterëve të parashikuara në udhëzimin nr 4, datë 11.03.2014.

-Zërat e shpenzimeve që përballohen nga Fondi Grand/transfertë korrente e brendshme janë :

-Financimi i kontratave të punësimit për 4 persona sipas dokumentacionit të audituar rezulton se; janë të lidhura 4 kontrata punësimi në kategorit respektive të pagës II-b për Sekretarin e Përgjithshëm, në përputhje me mandatin e përcaktuar në Statut dhe IV-a për 3 specialistët.

b. Për periudhën Janar 2016 deri korrik 2018 planifikimi i fondit grand/transfertë e brendshme korrente është me shkresat :

-Për vitin 2016 me shkresën nr. 11103/3 prot , datë 21.01.2016 grandit 8 000 000 lekë.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion fondi prej 8 000 000 lekë është planifikuar 4000000 lekë për shpenzime paga dhe 4000000 lekë për shpenzime për lojërat olimpike Rio 2016.

Sipas formatit të rakordimit të shpenzimeve me thesarin shpenzimet faktike janë 6 541 118 lekë, nga i cili:

fondi pagave 3.913.027

lojra olimpike 2.628.091 lekë.

Sa sipër vlera e mbetur është 1.458.882 lekë.

KOKSH-i me shkresën nr. 283, datë 30.11.2016 ka kërkuar paksim fondi në vlerën 1.400.000 lekë.

c. Fondi i akorduar nga MAS për Lojërat Olimpike Rio 2016 dhe përdorimi i tyre.

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë me shkresën nr 5127/1, datë 09.06.2016 bënë me dije se mbulimi i shpenzimeve për “Lojërat Olimpike” Rio 2016 të realizohen me fondet grand të alokuara nga MAS me shkresën nr 11103/3, datë 21.01.2016.

Sipas dokumentacionit të audituar fondi i akorduar për Lojrat Olimpike Rio është 4.000.000 lekë dhe përdorur si më poshtë vijon :

Realizimi i Fondit të Buxhetit për lojërat Olimpike :

në lekë

Nr.	Emërtimi	Plan	Fakt
1	Federata e Boksit	800 000	800 000

licencimet, donacionet, e drejta televizive, shitje bileta dhe cdo e ardhur tjetër, duke mos zbatuar pikën 6, germa a,b,c dhe d. Si rrjedhim MASR nuk ka marrë parasysh në planifikimin e grandit të ardhurat e krijuara nga KOKSH-i, duke mos zbatuar pikën 3 të Udhëzimit nr.4, datë 11.03.2014 “kriteret prioritare për përfitimin e fondeve buxhetore”.

3. Auditimi i Kontratave të punësimit për punonjësit që financohen me fondet e grandit/transferta korrente të brendshme.

Fondi pagave është miratuar për 4 punonjës me arsim të lartë të cilët paguhen sipas kategorive II-b, Sekretari i Përgjithshëm dhe 3 punonjës me IV-a

Sipas dokumentacionit të audituar rezulton se 2 specialistë paguhen me kategorine IV-a dhe një punonjës nuk ka arsim të lartë dhe është paguar me arsim të mesëm.

Nga auditimi i procedurave të rekrutimit të punonjësve dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës u gjetën në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet.

Nga verifikimi i dosjeve personale rezulton :

Me të gjithë punonjësit është lidhur kontrata me të dhënat personale.

Kohëzgjatja e kontratës për punonjësit që financohen nga buxheti Grand/transferta korrente të brendshme nuk mundë të jetë me e gjatë se mandati i përcaktuar në statutin e organizatës.

4. Auditim i pasqyrave financiare të fondeve “Grand/transfertë korrente të brendshme” të depozituar në MASR, brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, referuar ligjit” Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Pasqyrat financiare duhet të jenë konforme ligjit ku të përfshihen dhe të raportohen të gjitha të ardhurat nga burimet e ligjshme, si dhe të gjitha përdorimet/shpenzimet e kryera gjatë vitit ushtrimor.

Lidhur me këtë pikë ka rezultuar se:

- Në Ministrinë e Arsimit ,Sportit dhe Rinisë, janë raportuar vetëm shpenzimet e kryera nga fondi “Grand/transfertë korrente të brendshme”.
- Të ardhurat përfituara nga burime të tjera të ligjshme, si dhe shpenzimet nuk janë raportuar në MASR, **kjo është në kundërshtim me pikën 12, të udhëzimit nr 4, datë 11.03.2014.**
- U konstatua se KOKSH-i, raporton në Drejtorinë e Tatimeve, pasqyrat financiare për çdo vit kalendarik, si një organizatë jo fitimprurëse.

Grupi i auditit:

Merita Tershana

Vjollca Haxhiu



Plan veprimi, i sygjëruar nga auditi për zbatimin e rekomandimeve.

Nr	Rekomandim	Renditja sipas nivelit	Reagimi i menaxh. të subjektit	Afati i përcaktuar	Pers. përgjegjës
1	KOKSH si përfitues i fondeve "grand/transfertë korrente e brendshme, të paraqes në MASR dokumentacionin e përcaktuar në pikën 6 të Udhëzimit nr.4, datë 11.03.2014.	I Lartë	I pranuar		
2	Të raportohen në MASR të ardhurat e përfituara nga burime të tjera të ligjshme, në zbatim të pikës 12 të udhëzimit nr.4, datë 11.03.2014.	I Lartë	I pranuar		

Sekretar i Përgjithshëm i KOKSH

Stavri BELLO

Reagim nga subjekti i audituar

Subjekti i audituar: Komiteti Olimpik kombëtar Shqiptar
 Angazhimi i auditimit: Nr.8681/1 prot, datë 18.08.2018
 Data e raportimit: më 08.10.2018

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet tuaja, për të ndihmuar të vlerësojmë performancën tonë personale dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi i qasjen tonë do ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë.

Duke përdorur shkallën e vlerësimit si më poshtë, ju lutem rrethoni numrin në kolonën e djathtë që reflekton pikëpamjet tuaja në punën tonë, në secilën nga fushat e përmendura.

Shkalla e vlerësimit

(1) – Shumë të kënaqur (2) – Të kënaqur (3) – Të pakënaqur (4) – Shumë të pakënaqur

Komponentët e përfomancës (Sa të kënaqur jeni)		1	2	3	4	Komente
I Planifikimi i Auditimit						
1	Ju janë dhënë mundësi të përshtatshme për të rënë dakord në fushë veprimin e auditimit para se të fillonte?					
2	Ju është dhënë njoftimi i duhur për kohën dhe kohëzgjatjen e auditimit?					
II Kryerja e auditimit						
3	Audituesit e brendshëm kanë qenë profesionalë dhe të sjellshëm gjatë kryerjes së auditimit?					
4	Audituesit e brendshëm kishin njohuri të mjaftueshme në fushën e veprimtarisë suaj?					
5	A ju është komunikuar në mënyrën e duhur progresi i angazhimit të auditimit, duke përfshirë detajet e çështjeve kryesore që u shqyrtuan?					
III Raportimi i rezultateve të auditimit						
6	Projekt raporti është marrë Brenda një kohe të pranueshme të parashikuar?					
7	Projekt raporti është prezantuar në mënyrë të qartë ne lidhje me formatin dhe qartësinë e gjuhës së përdorur?					
8	Pas përgjigjeve të menaxhimit për komentet, raporti përfundimtar është marrë Brenda një kohe të pranueshme të parashikuar?					